

BELBËZIMI

Informacione mbi belbëzimin te fëmijët e vegjël

Si mund ta ndihmoni fëmijën që të flasë më rrjedhshëm?

Përqendrohuni në **brendinë** e asaj që flet fëmija, **jo** në mënyrën se **si** flet fëmija. Fëmija ndihet keq kur atij ia ndërprejnë të folurën. Mos flisni për fëmijën, por lejoni që fëmija ta shprehë vetë atë që dëshiron të flasë deri në fund. Mos e korrigjoni të folurën e fëmijës.

Rrini i qetë. Shikojeni fëmijën në sy, nëse fëmija e ka shumë të vështirë të flasë dhe belbëzon.

Flitni qetë me fëmijën dhe mos nxitoni. Mbani një pushim të shkurtër para se t'i përgjigjeni fëmijës. Në këtë mënyrë mund të ulni ndjesinë e nxitimit. Kur të flitni me fëmijën, përdorni fjali të thjeshta. Mos e pyetni fëmijën për shumë gjëra njëkohësisht.

Situatat e të folurës duhet të jenë të qeta. Mbyllni burimet kryesore të zhurmave, si për shembull, televizorin dhe radion. Kur e folura e fëmijës të jetë më e rrjedhshme, atëherë lejojani fëmijën të flasë shumë.

Kur fëmija belbëzon më shumë, atëherë flisni edhe ju gjepura dhe këndon bashkë me fëmijën. Në këtë rast, mos i bëni shumë pyetje fëmijës.

Trajtojani fëmijën që belbëzon si fëmijët e tjerë. Mos e lejoni fëmijën që belbëzon të bëjë punë, që nuk ia lejoni fëmijëve të tjerë. Mësojeni fëmijën që belbëzon që të mësojë për të dëgjuar pa i ndërprerë të tjerët.

Informacione të mëtejshme

Informacione të mëtejshme mbi belbëzimin, terapinë e gjuhës dhe kurset përkatëse, mund të merrni në këshillimore, te terapisti i gjuhës pranë vendbanimit tuaj, në Shoqatën finlandeze të personave që vuajnë nga belbëzimi dhe në Unionin e terapistëve të gjuhës, të Finlandës.

www.ankytys.fi
info@ankytys.fi



Print Mill Oy, 2010 - ALBANIA



Shoqata finlandeze e personave që vuajnë nga belbëzimi

*Kjo broshurë është në gjuhë të thjeshtuar.
Broshura është për prindët, kujdestarët dhe për të afërmit e tjerë të fëmijës që vuan nga belbëzimi.*

Përsëritja e fjalëve nuk përbën gjithmonë belbëzim. Fëmija në moshë të vogël mund ta thotë disa herë pa dashje të njëjtën fjalë ose fillimin e një fjale. Kjo është mjaft e përgjithshme dhe normale.

Belbëzimi ndodh kur fëmija përsërit fjalë ose pjesë të fjalë shumë herë dhe për një kohë të gjatë. Fëmija mund të përsërisë edhe një pjesë nga mesi i fjalës. Nëse fëmija belbëzon, atëherë ai mund të zgjasë disa tinguj sa herë që flet. E folura mund të ndërpritet për disa çaste.

Informacione mbi belbëzimin

- Belbëzimi shkaktohet nga shumë shkaqe të ndryshme. Sot besohet, se fëmija ka prirje për të belbëzuar që në fillim. Edhe ambienti ku rritet fëmija influencon në fillimin e belbëzimit të fëmija. Prirja për të belbëzuar shpesh gjendet në familje.
- Belbëzimi ndodh pa dashje. Kur fëmija belbëzon, ai/ajo nuk e bën atë me qëllim.
- Belbëzimi mund të fillojë në moshë të ndryshme. Shpesh belbëzimi fillon kur fëmija mëson të flasë dy fjalë njëra pas tjetrës. Belbëzimi i fëmijës mund të fillojë edhe më vonë, gjatë moshës shkollore.
- Belbëzimi mund të rehabilitohet. Pjesa më e madhe e fëmijëve që belbëzojnë, mësojnë të flasin rrjedhshëm para se të arrijnë moshën e rritur nëpërmjet rehabilitimit.
- Te djemtë belbëzimi ndodh më shpesh se te vajzat.
- Me belbëzimin lidhen edhe lëvizje të tepërta, për shembull rrahje e qepallave ose tundje e kokës. Gjithashtu, mund të ketë edhe ngritje të tonit të zërit.
- Belbëzimi të fëmijët e vegjël mund të ndryshojë në sasi dhe në cilësi. Fëmija mund të belbëzojë në situata specifike. Belbëzimi mund të zgjasë edhe për një kohë të gjatë, pastaj pushon dhe sërisht mund të fillojë.
- Jo të gjithë fëmijët e vënë re belbëzimin e tyre. Ndërsa ka fëmijë të tjerë që mund të mërziten dhe të vuajnë nga ankthi kur nuk mund të flasin rrjedhshëm.

Trajtimi i belbëzimit

Pjesa më e madhe e të folurës së fëmijës që belbëzon, është e rrjedhshme. Mënyra më e mirë për ta ndihmuar fëmijën, është duke e mbështetur dhe duke e përkrahur atë në çastet kur fëmija flet në mënyrë të rrjedhshme.

Është mirë të mendoni, se në cilat situata e folura e fëmijës është veçanërisht e rrjedhshme. A e ndihmojnë fëmijën situatat kur ai/ajo nuk ngutet, kur i rrituri ka kohë për ta dëgjuar fëmijën? A flet fëmija më rrjedhshëm kur nuk ka zhurma rreth e përçark? A flet fëmija më rrjedhshëm kur i rrituri flet ngadalë? A e ndihmon fëmijën, nëse i rrituri flet me fjali të thjeshta?

Nëse belbëzimi ka vazhduar mbi dhjetë vjet, atëherë ja vlen të kërkoni ndihmën e terapistit të gjuhës. Nëse simptomat janë shumë të fuqishme, atëherë ja vlen të kërkoni ndihmë edhe më shpejt.

Në terapinë e gjuhës rrjedhshmëria e gjuhës përforcohet duke u ushtruar nëpërmjet lojës. Prindët e fëmijëve të vegjël marrin pjesë në terapinë e gjuhës. Në terapinë e gjuhës ata mësojnë metoda të cilat mund t'i përdorin në jetën e përditshme. Edhe për të rriturit e tjerë që kujdesen për fëmijën është e rëndësishme të dijnë, se si mund ta ndihmojnë fëmijën të flasë më rrjedhshëm.

Me fëmijën duhet të flisni për belbëzimin. Nëse vetë fëmija mërzitet me belbëzimin, atëherë është shumë e rëndësishme që të flisni me fëmijën për atë. Kur t'i flisni fëmijës për belbëzimin, flisni me zë të butë. Belbëzimin mund ta përshkroni me fjalë, të cilat fëmija i njeh. Fëmijës mund t'i thuhet, për shembull, se "fjalët kërcëjnë". Edhe njerëzit e tjerë të afërm duhet të flitet hapur mbi belbëzimin e fëmijëve.

Për familjet me fëmijë që vuajnë belbëzimi organizohen kurse përgatitore për përshtatje. Në këto kurse prindët dhe fëmijët mund të takojnë familje të tjera, ku ka fëmijë që belbëzojnë. Në këto kurse mund të bisedohet edhe me ekspertë e belbëzimit. Edhe ushtrimet e të folurës janë pjesë e programit të kurseve.

